

VENDIM
Nr. 90, datë 27.2.2019

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 513, DATË 13.6.2013, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE E TË
DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 30, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Në aneksin nr. 3, “Lista e shteteve, shtetasit e të cilave hyjnë pa viza në Republikën e Shqipërisë dhe çfarë dokumenti duhet të paraqesin”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohen fjalët “... Rusi, Arabi Saudite, Bjellorusi, Katar, Oman, Tailandë, Bahrejn, me dokumentin pasaportë, për periudhën 1 prill deri më 31 tetor 2019, dhe Kinë, Republika Popullore, me dokumentin pasaportë, për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij vendimi deri më 31 tetor 2019”.

2. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama